



PERFORMANCA E SHOQËRISË

JANAR - QERSHOR

2018

AKTIVITETI EKONOMIK FINANCIAR

Treguesit Operacionalë

Treguesit e Aktivitetit Ekonomik	6-M I ^{trë} 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014
Energjia Neto e Prodhuar nga KESH (GWh)	3,881	2,915	5,092	4,452	3,409
Të Ardhura nga Shitjet (000 Lekë)¹	10,932,009	7,289,888	16,521,118	19,313,241	10,831,993
Fitimi/(Humbja) neto për periudhën (000 Lekë)	6,199,243	(52,727)	1,159,337	797,046	(22,240,662)
Llogari të Pagueshme detyrime (000 Lekë)	37,984,060	55,988,262	52,345,867	50,513,314	64,192,159
Llogari të Arketueshme (000 Lekë)	59,242,070	57,556,133	56,643,866	53,636,343	62,228,022
Shpenzimet Fikse Operacionale (000 Lekë)²	1,416,485	1,995,347	1,949,857	2,240,991	1,865,696
Shpenzime Operacionale (Lekë/GWh)	364.99	684.49	382.95	503.37	547.36

1) Të ardhurat prej 10,9 miliard Lekë konsistojnë në 3 miliard nga shitja e 1.99 TWh energji tek OSHEE (nga te cilat 2 miliard nuk janë arketuar akoma), 7,13 miliard nga shitja e 1,99 TWh energji në tregun e parregulluar, 581 milion nga shitjet e shërbimeve energjitike dhe 224 milion nga shitblerjet e energjisë për optimizim ekonomik.

2) Shpenzimet operative fikse të cilat lidhen vetëm me aktivitetin operacional të shoqërisë (pa përfshirë zhvlerësimin/amortizimin dhe blerjet e energjisë) janë rritur krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara për shkak të pagesës së detyrimit prej 500 milion lekë ndaj PVE/PPE.

Treguesit Financiarë (Borxhi Afatshkurtër)

Overdradhet dhe Normat e Interesit	6-M I ^{trë} 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014
Totali i Huave të b.vlefshme (000 Lekë)	16,557,680	33,914,199	31,988,576	33,679,278	34,011,261
Norma Mesatare e Interesave	3.03%	3.63%	3.97%	4.44%	5.15%
Shpenzimet për Interesa (000 Lekë)	546,742	1,229,634	1,268,961	1,495,906	1,753,098

Në qershor 2018 u lëvrua kësti i parë i kredisë së BERZH në shumën 14.460 mld. lekë me të cilat janë mbyllur 3 linja OD dhe është ulur limiti i dy linjave të tjera duke ulur shpenzimet për interesa

Gjatë rinovimit të linjave OD, u negociuan termat e huamarrjes me bankat tregtare duke sjellë përmirësimin e normës së ponderuar të interesave nga 3.63% në 3.03%, (apo rreth 100 milionë lekë më pak interesa për vitin 2018).

Treguesit Fiskalë

Pagesat e Detyrimeve Tatimore (000 Lekë)	6-M I ^{trë} 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)	1,523,670	657,553	350,414	506,826	269,710
Tatimi Fitimi	1,091,566	1,265,347	876,071	- -	90,000
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	131,785	229,462	258,230	232,315	224,936
Taksa dhe tarifa të tjera	3,442	323,967	1,252	7,420	343,841
TOTAL	2,750,463	2,476,328	1,485,967	746,561	928,487

Situata ekonomike e KESH sh.a. është përmirësuar ndjeshëm gjatë 6 mujorit të I^{trë} të vitit 2018 në sajë të administrimit proaktiv financiar të shoqërisë, gjë që reflektohet në uljen e detyrimeve ndaj të tretëve.

Të ardhurat e realizuara nga shitjet e energjisë elektrike në tregun e parregulluar (eksport) gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2018 janë përdorur për:

vijueshmërinë e aktivitetit minimal operacional të shoqërisë (shpenzimeve për paga; sigurime shoqërore e shëndetësore; shpenzime për interesa të linjave të OD, etj) pa realizuar asnjë investim te ri për këtë periudhë të viti 2018.

shlyerjen 100% të detyrimit prej 700 milion lekë ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për tarifën konkensionare për energjinë e prodhuar nga PPE&PVE për vitet 2012- 2016.

shlyerjen e detyrimit ndaj PPE&PVE me vlerë rreth 500 milionë lekë, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së Lartë Nr. 239, për shfuqizimin e Vendimeve të ERE nr.143/144, datë 26.12.2014.

dëmshpërblimin financiar të banorëve të qarkut Shkodër të prekur nga përmbytjet e vitit 2010 në zbatim të VKM nr. 295, datë 05.04.2017 në vlerën rreth 40 milionë lekë për 6 mujorin e parë 2018 duke shlyer në total 290 nga rreth 330 milionë lekë që ishte vlera e mbetur e detyrimit.


TRANSAKSIONET E ENERGJISË

Vepërtaria tregtare e KESH sh.a. kushtëzohet në mënyrë thelbësore nga detyrime të shumfishta për shërbimin publik të ngarkuara shoqërisë, duke sjellë për pasojë tregtimin e energjisë nga ana e saj në kushtet kur ka teprica energjie në tregun e brendshëm dhe atë rajonal. Kjo kufizon mundësitë e shoqërisë si për diversifikim e produkteve të energjitike, ashtu edhe për të rritur vlerën monetare të tyre.

Megjithë kufizimet që burojnë nga kuadri ligjor dhe rregullator i aplikueshëm, falë planifikimit dhe zhvillimit të aftësive tregtare të njëjësive përgjegjëse, si dhe menaxhimit proaktiv të operacioneve, KESH ka arritur të maksimizojë të ardhurat nga shitja e energjisë, duke ofruar energjinë për shitje në kohë dhe profile që mundësojnë çmime të favorshme duke u bazuar në parashikimet hidrometeorologjike dhe kërkesës rajonale për energji.

Reshjet intensive gjatë 6-mujorit të parë (dhe kryesisht në periudhën Janar–Prill) ishin një dëshmi që situata e “stresit” kaloi me sukses, pasi jo vetëm që nuk u kompromentua siguria e digave, por falë aftësive menaxheriale të stafit të shoqërisë, u arrit të maksimizohet sasia e energjisë së shitur në raport me shkarkimet e ujit pa prodhim energjie, duke mundësuar në të njëjtën kohë edhe kontroll më të mirë dhe minimizim të vërshimeve të ujit zonën e nën Shkodrës.

Volumi i Transaksioneve (mln. Euro)	6-M. I ^{re} 2018	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011
Blerjet e Energjisë në Tregun e Parregulluar	–	23.9	5.2	17.5	9.3	9.3	56.8	104.3
Shitjet e Energjisë në Tregun e Parregulluar	57.1	8.3	41.0	35.4	1.6	26.9	14.1	9.3



Shpenzimet për blerje energjie nga tregu i parregulluar (Import) kanë ardhur duke u reduktuar dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2018 nuk kemi import energjie.

Të ardhurat nga shitja e energjisë në tregun e parregulluar kanë ardhur duke u rritur dhe në 6 mujorin e parë të vitit 2018 rezultojnë 48.8 Milion Euro më shumë se viti 2017 dhe 34.5 Milion Euro më shumë se mesatarja e 5 viteve të fundit.

Efiçenca e transaksioneve energjitike	6-M. I ^{re} 2018	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011
Çmimi mesatar i Importit (Eur/MWh)	–	60.50	57.67	46.36	51.61	54.50	64.45	72.00
Çmimi Mesatar i Bursës HUPX (EUR/MWh)	40.62	50.50	35.43	40.59	40.48	42.33	51.49	55.81
Çmimi Mesatar i Exportit (Eur/MWh)	34.98	56.91	24.33	31.87	43.73	28.22	47.28	39.98

Shënim: Për reference janë marrë për baze çmimet mesatare të transaksioneve për profilin "Bande".

Optimizimi ekonomik i mundëson KESH sigurimin e të ardhurave shtesë, si rrjedhojë e diferencës midis çmimeve të shitjes dhe të blerjes së energjisë pa ndikuar në rezervën energjitike.


Transaksionet Komerciale	6-M-I-rë 2018			2017			2016			2015			2014		
	Sasia Mwh	Çmimi Mesatar €/Mwh	Vlera Totale €	Sasia Mwh	Çmimi Mesatar €/Mwh	Vlera Totale €	Sasia Mwh	Çmimi Mesatar €/Mwh	Vlera Totale €	Sasia Mwh	Çmimi Mesatar €/Mwh	Vlera Totale €	Sasia Mwh	Çmimi Mesatar €/Mwh	Vlera Totale €
Blerje energjie elektrike	27,720	46.67	1,293,639	51,420	42.80	2,200,600	40,020	30.19	1,208,118	19,614	31.39	681,896	26,280	50.24	1,451,434
Shitje energjie elektrike	27,720	64.06	1,775,670	51,870	55.25	2,865,862	40,152	38.21	1,534,078	19,614	44.68	984,906	26,280	60.14	1,580,526
Efekt Financiar per KESH (te ardhura nga shitja - blerja)			482,031			665,263			325,960			303,010			129,092

Proçesi i optimizimit realizohet, në ato momente që lejon sistemi, duke blerë një sasi energjie gjatë orëve të natës (kur çmimi i energjisë është i ulët) dhe duke e shitur po të njëjtën sasi energjie me çmim më të lartë gjatë orëve të ditës.



SHFRYTËZIMI I BURIMEVE

Prurjet dhe Prodhimi		6-M I ^{re} 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014	Viti 2013	Mesatarja Sh. vjeçare
Prurjet në Fierzë (m3/sec)		388	131	228	176	143	241	172
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)		225.6%	76.2%	132.6%	100.6%	82%	140.1%	
Prodhimi i Kaskadës (GWh)		3,914	2,945	5,111	4,496	3,414	5,815	4,073
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)		96.1%	72.3%	125.5%	116.7%	88.7%	142.8%	
Eficenca ne Gjenerim		6-M I ^{re} 2018	2017	2016	2015	2014	2013	Mesatarja Sh. vjeçare
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m3/kWh)	3.49	4.14	3.61	3.66	3.79	3.73	3.87
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	294.28	274.83	290.54	288.68	284.80	286.38	277.77
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	90.0%	94.0%	91.0%	90.0%	90.0%	89.0%	80.0%
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m3/kWh)	4.20	4.14	4.14	4.15	4.16	4.19	4.22
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	172.50	172.96	173.27	173.16	173.04	172.89	171.29
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	87.0%	82.0%	85.0%	82.0%	78.0%	75.0%	76.0%
HEC Vau Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m3/kWh)	8.47	8.52	8.45	8.51	8.48	8.48	8.41
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	74.60	73.91	74.32	74.04	74.24	74.25	73.94
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	89.0%	80.0%	82.0%	84.0%	84.6%	85.0%	85.0%



Shfrytëzimi dhe Menaxhimi i Prurjeve Natyrale në Kaskadën e lumit Drin

Analizë krahasimore për vite me situatë të ngjashme hidrike

Treguesit e 6-mujorit I ^{re} për vitet:	2018	2013	2010	Mesatarja 15 vjeçare	6-M I ^{re} 2018 / Mes. 15 V.
Niveli në Fillim Janar (mmnd)	289.72	276.64	292.65	280.06	+9.66
Niveli në Fillim Korrik (mmnd)	296.18	294.18	293.12	290.63	+5.55
Rezerva Energjetike 1 Korrik (GWh)	1,399	1,305	1,256	1,149	122%
Prodhimi (GWh)	3,914	3,705	4,173	2,557	153%
Prurjet Natyrale në Drin (m ³ /sek.)	621	629	691	407	153%
Shkarkimet nga Tunelet (miliard m ³)	4.1	3.0	6.8	1.5	276%
Kapacitetet Gjeneruese në dispozicion (MW)	1,189	1,350	1,350	1,350	88%

Gjashtëmujori i parë i vitit 2018 rezultoi të jetë me prurje 621 m³/s shume më të larta se mesatarja shumëvjeçare (407 m³/s) dhe njehkohësisht i krahasueshëm me gjashtëmujorin e parë të viteve 2010 (691 m³/s) dhe 2013 (629 m³/s).

Prodhimi i kaskadës në 6-mujorin e parë të këtij viti është **3,914 GWh** ose rreth **53% më shumë se mesatarja** e 15 viteve të fundit (2557 GWh) si dhe rreth **200 GWh më shumë se në vitin 2013**, për të njëjtën sasi prurjesh. Gjatë kësaj periudhe u regjistruan vlerat më të larta historike të prodhimit ditor (29,121 MWh), të prodhimit mujor (848.5 GWh), dhe të rezervës energjetike në fillim të muajit Korrik (1,399 GWh). Për shkak të rehabilitimit në HEC Koman dhe kufizimeve në transmetim, kapacitetet gjeneruese të disponueshme për shfrytëzim gjatë periudhës ishin rreth 161 MW më të vogla se në vitet 2010 e 2013.

Ndërkohë që për nivele pothuajse të njëjta prodhimi, **shkarkimet pa prodhim të energjisë** elektrike në vitin 2018 ishin rreth **40% më të ulta se ato 2010^{es}**. Për të njëjtën periudhë, **rezerva energjetike e kaskadës në vitin 2018 u rrit me rreth 288 GWh**, ndërkohë që në 2010ⁿ (megjithëse me prurje më të larta) ajo u rrit me vetem 21 GWh.

Ndryshe nga vitet 2010 e 2013, **prej 1 Janarit 2018 KESH është subjekt i disbalancave** si dhe **pale përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve ndihmëse**. Megjithëse i ndodhur në kushtet e trysnisë së jashtëzakonshme të përbushjes së detyrimeve të shumfishta për shërbim publik, **KESH arriti të planifikojë dhe prodhojë në nivele maksimale pa shkaktuar disbalanca esenciale**.

MIRËMBAJTJA E HIDRO-AGREGATËVE

Treguesit e Mirëmbajtjes për 6-M. e I ^{re} të:	Vitit 2018	Vitit 2017	Vitit 2016	Vitit 2015	Vitit 2014	Vitit 2013	Mesatarja 10-Vjeçare
Orët e Punës së Agregateve (OP)	44,750	25,665	32,964	37,119	20,723	44,210	33,934
Orët e Agregateve në Avari (OA)	23,6	24,4	19,1	25,7	55,9	123,0	104,0
Koeficienti i Gadishmërisë (OP/OP+OA, %)	99.94	99.90	99.94	99.93	99.73	99.72	99.69
Rastet e Avari-Difekteve (RAD)	15	18	16	23	35	68	50
Orë Pune midis Difekteve (OP/RAD)	2,983	1,426	2,060	1,614	592	650	675

Edhe gjatë 6-mujorit të I^{re} të vitit 2018, treguesit e mirëmbajtjes vijojnë të përmirësohen në krahasim me të njëjtën periudhë të viteve të mëparshëm si dhe me mesataren e 10 viteve të fundit. Krahas situatës të favorshme hidrologjike performanca e mirëmbajtjes është përmirësuar si rrjedhojë e gadishmërisë së lartë të agregatëve për operim, efikasitetit të kontrolleve të vazhdueshme parandaluese,

shërbimeve cilësore të mirëmbajtjes gjatë remonteve profilaktike e të mesme, si dhe investimeve për rinovimet teknologjike të agregatëve e paisjeve të tjera në tre HEC-et e kaskadës së Drinit





Gjatë 6-mujorit të I^{re} të vitit 2018, për shkak të kufizimeve në kapacitetet gjeneruese të disponueshme për shfrytëzim, agregatët kanë realizuar më shumë orë pune krahasimisht me të gjithë 6-mujorët e I^{re} të 10 vjeçarit të fundit.

Orët e punës së agregatëve janë rritur me 31.9% më shumë krahasuar me mesataren e 6-mujorit të I^{re} të 10 viteve të fundit, ose 74% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2017.

Gadishmëria e agregatëve për operim është rritur me 0.25% krahasuar me mesataren e 6-mujorit të I^{re} të 10 viteve të fundit ndonëse hidroagregatët kanë punuar pothuajse pa ndërprerje dhe me regjim maksimal ngarkese duke shfrytëzuar maksimalisht potencialet hidrike të krijuara nga situata e favorshme hidrologjike.

Orët e ndërprerjeve për kohë të shkurtër të agregatëve për shkak të anomalive kalimtare, janë ulur në 23.6 orë, apo mbi 4 herë më pak se mesatarja e 6-mujorit të I-re të 10 viteve të fundit.

Për të gjitha rastet e avarive të agregatëve të tre HEC-ve të kaskadës së Drinit, asnjëherë ndalimi i tyre nuk ka kapërcyer kohëzgjatje që imponojnë remonte të parakohëshme për riparime kapitale. Shumica e ndalimeve të agregatëve për interval kohe të shkurtëra, kanë ardhur nga anomali të rrjetit të Sistemit Energjitik, i cili përballoi flukset më të larta fizike të energjisë të transmetura ndonjëherë.





Pas gjashtë dekadash histori të mbushura me ngjarje që motivojnë ecjen përpara me një qasje frymëzuese për të ardhmen, **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare** dhe stafi i saj ndjehen krenar për historinë sfiduese por me rezultate pozitive të arritura.

Vijojmë aktivitetin tonë në dekadën e shtatë më të strukturuar, më eficientë dhe më të shëndetshëm financiarisht.

Pas një pune intensive gjatë viteve të fundit për **garantimin e sigurisë** së digave, **ritjen e efijencës** së prodhimit dhe **përmirësimin e kushteve të punës** në HEC-et e kaskadës, vijmë me **Zyrat e reja Qendrore me kushte fizike dhe funksionale dinjitoze për imazhin e shoqërisë dhe me hapësirat e nevojshme për ushtrimin normal te aktivitetit nga administrata; (1790 m² godinës ekzistuese, 440 m² ndërtim i ri dhe 650 m² ambjent i jashtëm).**

Punimet rehabilituese të Zyrave Qendrore të KESH evidentojnë:

- **Cilësi dhe standart:** Rikonstruksioni i godinës u krye duke respektuar të gjitha kërkesat arkitektonike, strukturale dhe elektro-mekanike
- **Respektim të treguesve të sigurisë dhe shëndetit në punë:** Materialet e përdorura si në pjesën e brendshme ashtu e në fasadën e godinës janë të standardeve bashkëkohore dhe në funksion të sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësit.
- **Imazh dhe përfaqësim dinjitoz:** Simbolika arkitektonike në fasadë e bën këtë godinë të veçantë, tërheqëse dhe përfaqësuese për Korporatën dhe imazhin e saj në marrëdhënie me çdo partner vendas apo të huaj.

ADMINISTRATORI
Agim HETOJA

